

VENDIM
Nr. 592, datë 15.10.2025

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.12.2024, PËR ÇËSHTJEN “RAMAJ KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 17758/06)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.12.2024, për çështjen “Ramaj kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr. 17758/06, përfundimtar në datën 28.4.2025, në shumën 4 000 (katër mijë) euro, në lidhje me dëmin jopasuror, dhe shumën 10 000 (dhjetë mijë) euro, në lidhje me kostot e shpenzimet, plus çdo taksë, që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shumën, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuarit Eduart Ramaj, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.12.2024, për çështjen “Ramaj kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 17758/06.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3 të këtij vendimi, në favor të kërkuarit, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afati 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi përballohen nga fondet rezervë të buxhetit të shtetit për vitin 2025.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama